

## **Procedura aktuale e riatdhesimit**

Procedura aktuale e riatdhesimit parashikon se të gjithë qytetarët që do të riatdhesohen, duhet të aksesojnë direkt faqen e Air Albania [www.airalbania.com.al](http://www.airalbania.com.al) për të kryer rezervimin e biletës dhe për t'u rikthyer në atdhe.

Gjatë këtij procesi ata duhet të deklarojnë adresën e tyre të banimit, pasi të gjithë qytetarët e riatdhesuar duhet të karantinohen në banesat e tyre për 14 ditë.

Gjatë udhëtimit, në bordin e Air Albania qytetarët do të plotësojnë me përgjegjësi të plotë ligjore formularin e vetdeklarimit, ku do të shkruajnë edhe një herë adresën e banimit dhe më pas duhet ta firmosin. Ky formular i ngarkon shtetasit e riatdhesuar me përgjegjësi ligjore dhe në rast deklarimi të rremë do të aplikohen masa penale sipas ligjeve në fuqi.

Policia e Shtetit do të monitorojë procesin e karantinimit të shtetasve të riatdhesuar.